

20151524365

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BIBLIOTEKA

Neni 1

Në Ligjin për biblioteka ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/2004, 89/2008, 116/10, 51/11 dhe 88/15) në nenin 52 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

„(2) Gjorbë në lartësi prej 30% nga gjoba e përlloragitur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”.

Neni 2

Në nenin 52-a paragrafi (1) në fjalinë hyrëse fjalët: “1.000 deri” shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Gjorbë në lartësi prej 30% nga gjoba e përlloragitur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”.

Neni 3

Neni 52-b ndryshohet si vijon:

“Përlloragitja e lartësisë së gjorbës për personin juridik dhe tregtarin individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”.

Neni 4

Në nenin 52-g në paragrafin (7) pas fjalës “organ” shtohen fjalët: “mban procedurën për kundërvajtje në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet dhe”.

Paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

“Kundër vëndimit për kundërvajtje që e ka miratuar Komisioni për kundërvajtje mund të parashtrojë ankesë në Komisionin Shtetëror për vendosje në shkallë të dytë në fushën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurën për kundërvajtje.”

Neni 5

Titulli i nenit dhe neni 52-d ndryshohen si vijojnë:

“Procedurë për lëshim të urdhërpagesës për kundërvajtje

“Neni 52-d

(1) Për kundërvajtjet e caktuara në nenet 52 dhe 52-a të këtij ligji, inspektori për kulturë kryerësit të kundërvajtjes do t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën për kundërvajtje, i njëjti duhet ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës për kundërvajtje nga kryerësi i kundërvajtjes regjistrohet në procesverbalin.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohet mënyra se si do të mënjanohen pasojat e dëmshme të kundërvajtjes, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e kryer.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën për kundërvajtje e nënshkruan personi përgjegjës ose person i autorizuar nga ai.

(5) Inspektori për kulturë është i obliguar të mbajë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara dhe për rezultatit e procedurave të filluara.

(6) Në evidencën e paragrafit (5) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimin, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) të këtij neni ruhen pesë vite nga dita e futjes në evidencën.

(8) Ministri i kulturës përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtjen.”

Neni 6

Akti nënligjor i caktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.